

## Kombetarja nuk gjen stadium per stervitje

nga AlbaniaSoccer  
E hënë, 09 Gusht 2010 21:23

---



Kombetarja shqipetare ne diten e dyte te grumbullimit ne prag te miquesores me Uzbekistanin, ka hasur veshtiresi per te gjetur nje stadium ku te stervitet. Pas disa peripecirash dhe nje ore sorollatje neper kryeqytet, kuqezinjte kane mundur te sterviten normalisht, pasi Tirana ka nderprere seacen stervitore, per t'ja lene "Skender Halilin" lojtareve te Kuzhes.

Pavaresisht paralajmerimeve rreth nje jave me pare te kompleksit "Skender Halili", apo edhe te stadiumit "Selman Stermasi", stervitja ne diten e dyte te grumbullimit te perfaquesueses sone pervecse eshte shtyre ne orar nga ora 18:00 ne 18.30, ka hasur edhe veshtiresi ne gjetjen e nje vendi per t'u stervitur, gje qe e ka nervozuar jo pak trajnerin kroat Josip Kuzhe.

Ne kompleksin sportiv "Skender Halili", ne orarin e paralajmeruar per stervitjen e kombetares po zhvillonte seancen stervitore Tirana, duke i detyruar lojtaret qe te shkojne per ne stadiumin "Selman Stermasi", por edhe aty ishte e pamundur.

Ne kete stadium kishte filluar stervitjen ekipi kundershtar i Uzbekistanit, i cili mberriti diten e sotme ne Tirane.

Konfuzioni i krijuar e nxorri 22-shen e kombetares ne nje aneks te kompleksit "Skender Halili", ne pritje te perfundimit te stervitjes se Tiranës.

Nga ora 18:00, e percaktuar per t'u zhvilluar kjo seance stervitore, trajneri dhe stafi i tij u detyruan qe te fillojne stervitjen nje ore me vonese.

Pas gjithe ketyre peripecirave, ekipi perfaquesues ka zhvilluar seancen stervitore normalisht ne diten e tij te dyte, ku trajneri Kuzhe po sheh nga afer gjendjen e lojtareve dhe po perqatitet per ndryshimet e reja te formacionit me elementet e rinj te grumbulluar.

## Kombetarja nuk gjen stadium per stervitje

nga AlbaniaSoccer  
E hënë, 09 Gusht 2010 21:23

---

Ndeshja miqesore me Uzbekistanin do te zhvillohet diten e merkure ne stadiumin e rikonstruktuar te Durresit, "Niko Dovana", dite ne te cilen do te inaugurohet dhe impianti i ri i ndricimit.

Enea Shtrepi